

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 39, datë 16.3.2022

PËR MODALITETET E NEVOJSHME ORGANIZATIVE DHE TEKNIKE PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI KËRKUESIT PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 58, pika 4, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Brendshëm dhe ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

1. Kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare, në çdo fazë të procedurës për përcaktimin e statusit, në kushtet e pamundësisë financiare për të mbuluar shpenzimet përkatëse, i ofrohet ndihma juridike falas e garantuar nga shteti.

2. Kërkuesit i ofrohet ndihma juridike falas e garantuar nga shteti, në lidhje me:

- a) informacionin për të drejtat dhe detyrimet e tyre;
- b) hartimin e ankimeve për vendimet që merren gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës;
- c) hartimin e akteve dhe përfaqësimin në procedurat administrative para autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe para gjykatës për ankimin e vendimeve të marra gjatë shqyrtimit të kërkesës.

3. Ndhmën juridike, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, mund ta japin ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

4. Kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare, që plotëson kushtin e përcaktuar në shkronjën “h”, të nenit 11, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, konsiderohet përfitues në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike falas.

5. Kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare i ofrohet ndihmë juridike parësore ose dytësore, në varësi të shërbimit të kërkuar, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

6. Kërkesa për ndihmë juridike parësore bëhet me gojë ose me shkrim nga kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare, pranë qendrave, që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore, organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga ministri i Drejtësisë ose klinikave ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

7. Për të përfituar ndihmën juridike parësore, kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare nënshkruan një vetëdeklarim, sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues.

8. Kërkesën për ndihmë juridike dytësore, kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare e paraqet personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë gjykatës.

9. Kërkesa, sipas pikës 8 të këtij udhëzimi, mund të paraqitet edhe nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor apo të pajisur me prokurë ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es, ose një të afërmi të shkallës së parë.

10. Për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare nënshkruan një vetëdeklarim, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga ministri i Drejtësisë, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues.

11. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe për refugjatët, me kërkesë të kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare, e asiston në plotësimin e dokumentacionit procedural të nevojshëm për përfitimin e ndihmës juridike falas parësore apo dytësore, deri në përfundimin e procedurave ligjore për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare, si dhe të garantimit të aksesit të kërkuesit për

mbrojtje ndërkombëtare në ndihmën juridike falas, me qëllim zbatimin efektiv të parashikimeve ligjore në fuqi që lidhen me ofrimin e ndihmës juridike falas.

12. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mund të bashkëpunojë me autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët për lehtësimin e aksesit të kërkuësve për mbrojtje ndërkombëtare në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, me qëllim ofrimin e ndihmës pranë institucioneve rezidenciale, ku janë të strehuar kërkuësit.

13. Procesverbalet e mbajtura gjatë ofrimit të ndihmës juridike parësore kërkuësit për mbrojtje ndërkombëtare nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore apo organizatat jofitimprurëse të autorizuar i vendosen në dispozicion autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

14. Ngarkohen Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike dhe autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Ministrinë e Brendshme për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja